

**UDHËZUES PËR PLOTËSIMIN E FORMULARIT A1Z**  
**Matura Shtetërore 2019**

1. **Formulari A1Z** plotësohet online. Procedura e plotësimit do të bëhet sipas një udhëzimi të veçantë.
2. Plotësimi i **Formularit A1Z** fillon në Portalin Qeveritar e-albania, dhe përfundon në shkollë në portalin e Maturës.
3. Formulari A1Z plotësohet nga:
  - a) Kandidati/kandidatja që ka përfunduar shkollën e mesme para vitit 2019 dhe që ka detyrim për të dhënë një ose disa provime të Maturës Shtetërore;
  - b) Kandidati/kandidatja që ka kryer arsimin e mesëm jashtë vendit, i cili/e cila pasi ka bërë njehsimin e diplomës në komisionin përkatës, në QSHA, rezulton se ka detyrim për të dhënë një ose disa provime të Maturës Shtetërore;
  - c) Kandidati/kandidatja që ka përfunduar shkollën e mesme në Shqipëri ose jashtë vendit, që nuk kanë detyrim për të dhënë provime në MSH 2019, por që dëshiron të vazhdojë studimet në Institucionet e Arsimit të Lartë (IAL).
4. Procesi i plotësimit të **Formularit A1Z** në shkollë ndiqet nga një person i ngarkuar nga drejtorja e shkollës, që do të quhet "mbikëqyrës".
5. Mbikëqyrësi pajiset me kodin përkatës të hyrjes në sistem. Vetëm pasi mbikëqyrësi vendos kodin në sistem, kandidati/kandidatja mund të përfundojë plotësimin e **Formularit A1Z**.
6. Kandidati/kandidatja për të plotësuar formularin A1Z, duhet të paraqesë tek mbikëqyrësi një vërtetim të lëshuar nga shkolla, i cili pasqyron provimet që ai ka dhënë dhe rezultatet që ai ka marrë në to. Vërtetimi, veç gjeneraliteteve duhet të ketë edhe këto të dhëna:
  - a) Provimet e detyruara dhe vlerësimet e shkallëzuara të secilit provim, nëse ato rezultojnë të fituara nga kandidati/kandidatja.
  - b) Provimin me zgjedhje që dëshiron të mbartë kandidati/kandidatja dhe vlerësimin e shkallëzuar të tij.Vërtetimi pas përfundimit të aplikimit i bashkëngjitet kopjes së formularit A1Z, që mban shkolla dhe dorëzohet në QSHA, 5 ditë pas përfundimit të aplikimeve.
7. Formulari i plotësuar printohet, nënshkruhet nga kandidati/kandidatja dhe mbikëqyrësi si dhe vuloset nga drejtori i shkollës ku plotësohen formularët A1Z. Shkolla ruan një kopje të formularëve të printuar deri në përfundim të Maturës Shtetërore 2019.

## I. Të dhënat personale

### Plotësohen nga kandidati

- **Tek pika 1 e formularit A1Z**, (numri personal i letërnjoftimit (ID)), kandidati/kandidatja shënon numrin e tij personal që ka në dokumentin e identifikimit. Ky informacion është i detyrueshëm dhe pa plotësuar atë nuk mund të vijohet me aplikimin.

Për të dhënat në pikat **2-5 të formularit A1Z**, pas plotësimit nga kandidati/kandidatja, sistemi bën verifikimin e tyre dhe nuk lejon të vazhdohet aplikimi, nëse ka pasaktësi.

- **Tek pika 6 e formularit A1Z**, kandidati/kandidatja shënon në fushat përkatëse adresën e email-it dhe numrin e telefonit, të cilat duhet të ruhen të pandryshuara deri në fund të Maturës Shtetërore 2019, me qëllim që ai/ajo (kandidati/kandidatja) të marrë informacion në faza të ndryshme të procesit.

Nëse kandidati/kandidatja nuk ka telefon, ose nuk dëshiron të shënojë numrin e telefonit, atëherë mbikqyrësi shënon numrin e tij të telefonit.

- **Tek pika 7 e formularit A1Z**, kandidati/kandidatja zgjedh nga lista Po ose Jo.

## II. Të dhëna shkollore

Të dhënat shkollore do të plotësohen në bashkëpunim me **mbikëqyrësin** e sallës ku bëhet aplikimi. Për plotësimin e saktë të kërkesave të këtij grupimi, kandidati/kandidatja dhe mbikëqyrësi duhet të marrin informacion të saktë dhe të plotë për rubrikat përkatëse:

### Plotësohen nga kandidati

- **Tek pika 8 e formularit A1Z**; (emri i qytetit/fshatit), kandidati/kandidatja shënon emrin e qytetit/fshatit ku ndodhet shkolla ku ai/ajo ka studiuar.
- **Tek pika 9 e formularit A1Z**; (emri i shkollës ku ka studiuar), kandidati/kandidatja shënon emrin e shkollës ku ai/ajo ka përfunduar studimet.

### Plotësohen nga mbikqyrësi

- **Tek pika 10 e formularit A1Z**, mbikqytësi plotëson emrin e DAR/ZA-së përkatëse.
- **Tek pika 11 e formularit A1Z**, (Indeksi i profilit), zgjidhet nga lista (Indeksi i profilit/degës) numri dyshifror që i përket emërtimit të profilit të shkollës ku ka studiuar kandidati/kandidatja ose ai që është përcaktuar nga komisioni i njehsimit të diplomave për shtetasit që kanë përfunduar shkollën e mesme jashtë vendit, sipas shkresës së lëshuar nga komisioni.
- **Tek pika 12**, (emërtimi i profilit) mbikqyrësi plotëson emrin e profilit.